

VENDIM
Nr. 988, datë 9.12.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 430, DATË 2.7.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI UNIVERSITETIT TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 117, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr. 430, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohet prona me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Punëve të Brendshme, Universiteti i Tiranës dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

INVENTARI I PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE TE UNIVERSITETIT TE TIRANES

Institucioni i pushtetit Qëndror Ministria e Arsimit dhe Sporteve											
Bashkia e Tiranës											
Fusha e përdorimit të pronës Universiteti i Tiranës											
Nr.	Zona Kadastrale & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurie	Lloji i Prones	Komuna / Bashkia	Emri i Prones Adresa	Sip. Tot. e Prones (m2)	Sip. Godine ne Prone (m2)	Funksion i Prones	Institucioni qe administron pronen	Njesia Perdoruese	Akti normativ i lenies ne administrim
19	8160 TR-S- 14	5/80,93	God. + Truall	B. Tirane	Terenet Sportive	28800	160	Arsim	U T	Rektorati	VKM Nr.834, dt 13.12.2006